



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
REKTORATI

Nr. 1493/Prot
13

Tiranë më 22.10.2020

VENDIM

Nr. 4, datë 19.10.2020

“Mbi shpërndarjen e kuotave të parealizuara në programet e studimeve të ciklit të parë “Bachelor” dhe në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë në fushën e drejtësisë, për vitin akademik 2020-2021”

Bazuar në ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 40; në VKM nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL”, pika 2.7, gërma b; në Statutin e Universitetit të Tiranës neni 36, pika 3, gërma g; në Vendimin nr.12, datë 30.04.2020 të Senatit Akademik të UT pika 2, Rektorati në mbledhjen e tij të datës 19.10.2020 :

VENDOSI

1. Kuotat e parealizuara për kandidatët studentë nga trojet shqiptare; shtetas të huaj; nga kategoritë e veçanta (me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe kandidatë student Romë dhe Ballkanë-egjiptiane); që aplikojnë për transferim studimesh; që aplikojnë për një program të dytë studimi, të shpërndahen sipas kërkesave të njësive kryesore të UT.
2. Njësitë kryesore të UT të përcjellin në Rektorat kërkesat për përshtatjen e kuotave të parealizuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI
Prof. Dr. Artan Hoxha

